DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-670/1
Data Datum Date 18.06.2018

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova-Republic of Kosovo

## Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| **Për:** | **Mytaher Haskuka,** Kryetar i Komunës së Prizrenit<br>**Artan Abrashi,** Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prizrenit | |
| **Cc:** | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| **Përmes:** | **Ivan Todosijević**, Ministër i MAPL-së<br>**Rozafa Ukimeraj**, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së | |
| **Nga:** | **Shkelqim Jakupi**, Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | Datë: 11/06/2018<br>Nr.020-670 |
| **Lënda:** | Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Prizrenit | |
| **Lloji i aktit:** | Vendim i Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktet komunale në vijim:

| |
|---|
| **Vendim Nr.001-011-82539 për bashkëpunim komunal ndërkombëtarë** |
| **Të miratuar më datë: 31/05/2018** |
| **I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 07/06/2018** |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së akteve të komunës si më sipër, vlerëson se aktet e komunës **janë në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tilla mund të prodhojnë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-670/1
Data Datum Date 18.06.2018

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
## Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| **Za:** | **Mytaher Haskuka**, gradonačelnik Opštine Prizren<br>**Artan Abrashi**, predsedavajući Skupštine opštine Prizren | |
| **Cc:** | Jedinici za administraciju dokumentacije u MALS-u<br>Jedinici za administraciju dokumentacije u opštini | |
| **Preko:** | **Ivan Todosijević**, ministar MALS-a,<br>**Rozafa Ukimeraj**, generalna sekretarka u MALS-u, | |
| **Od:** | **Shkëlqim Jakupi** rukovodilac Odeljena za zakonska pitanja i monitorisanje opština, MALS | Datum, 11/06/2018.<br>Br.020-670 |
| **Premet:** | Potvrda zakonitosti akta opštine Prizren | |
| **Vrsta akta:** | Odluka Skupštine opštine | |

Poštovani gradonačelniče,
Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| **Odluka br.001-011-82539 za međunarodnu opštinsku saradnju** |
| **Usvojena dana, 31.05.2018** |
| **Predložena za razmatranje u MALS-u dana, 7.06.2018** |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je isti u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni učinak.

Ministartsvo administracije lokaklne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.

DALËSE-IZLAZ-ÇIKIŞ

004-011-82539 31.05.2018

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren - Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 12 paragrafit 1. dhe nenit 30 paragrafit 1. të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 1 dhe nenit 18. paragrafit 1. të Ligjit për Bashkëpunim Ndërkomunal, nenit 6 paragrafit 1.2.3. të Rregullores për procedurat e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar, nenit 19 dhe nenit 27 paragrafit 1. të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur me 31 maj 2018, miratoi këtë

# VENDIM
## PËR BASHKËPUNIM KOMUNAL NDËRKOMBËTAR

### Neni 1

Bashkëpunimi komunal ndërkombëtar do të zhvillohet në mes të Komunave si në vijim:

1. Komunës së Prizrenit të Republikës së Kosovës
2. Bashkisë së Beratit të Republikës së Shqipërisë

07.06.2018

01-020-670

### Neni 2

Qëllimi i bashkëpunimit është: zgjerimi i shkëmbimeve dhe eksperiencave në sektorët e kulturës, ekonomisë, turizmit, trashegimisë, me qëllimin për të dhënë një kontribut për forcimin e marrdhënieve ndërmjet qyteteve.

Bashkëpunimi do të zbatohet mbi baza të njëjta resiprociteti dhe përfitimit të shumëanshëm në mbrojtjen e interesit të përgjithshëm publik.

### Neni 3

**Autorizohet:** Kryetari i Komunës së Prizrenit, Prof. Dr. Mytaher Haskuka, që në emër të Komunës së Prizrenit, të vazhdoj konsultimet - bisedimet me personat e autorizuar të Bashkisë së Beratit, rreth hartimit dhe nenshkrimit të marrëveshjes për binjakëzimin e Komunës së Prizrenit të Republikës së Kosovës, me Bashkinë e Beratit të Republikës së Shqipërisë.

### Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi, do të kujdeset Kryetari i Komunës së Prizrenit.

## Neni 5

Ky Vendim, hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të prodhojë efekt juridik pas vlerësimeve sikurse në nenin 81 dhe 82 të LVL-së.

KOMUNA E PRIZRENIT
Kuvendi i Komunës
Nr. 001/011-82539
Me 31 maj 2018
P r i z r e n

Kryesuesi i Kuvendit
Artan Abrashi

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

001-011- 82539 31.05.2018

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Na osnovu člana 12 paragrafa 1. i člana 30 paragrafa 1. Zakona za Lokalnu Samoupravu, člana 1 i člana 18 paragrafa 1. Zakona za Međuopštinsku Saradnju, člana 6 paragrafa 1.2.3. Pravilnika za procedure međunarodne opštinske saradnje, člana 19 i člana 27 paragrafa 1. Statuta Opštine Prizren, nakon razmatranja predloga Predsednika Opštine, Skupština Opštine Prizren, na svojoj održanoj sednici dana 31 maja 2018 godine, usvojio je ovu:

# O D L U K U
# ZA MEĐUNARODNU OPŠTINSKU SARADNJU

## Član 1

Međunarodna Opštinska saradnja će se odvijati između Opština kao u nastavku:

1. Opštine Prizren Republike Kosova.
2. Zajednice Berat Republike Albanije.

## Član 2

Cilj saradnje je: proširavanje razmene i iskustava iz sektora kulture, ekonomije, turizma, nasleđa, u cilju davanja doprinosa za ojačavanje odnosa između gradova.

Saradnja će se primenjivati na istoj osnovi reciprociteta i višestrane koristi u zaštiti opšteg javnog interesa.

## Član 3

Ovlašćuje se: Predsednik Opštine Prizren, Prof. Dr. Mytaher Haskuka, da u ime Opštine Prizren, nastavi konsultacije – pregovore sa ovlašćenim osobama Zajednice Berat, oko izrade i potpisivanja saradnje za pobratimljenje Opštine Prizren Republike Kosova sa Zajednicom Berat Republike Albanije

## Član 4

Za sprovođenje ove Odluke, staraće se Predsednik Opštine Prizren.

## Član 5

Ova Odluka, stupa na snagu na dan usvajanja i proizvešće pravni efekat nakon procena kao u članu 81 i 82 ZLS.

OPŠTINA PRIZREN
Skupština Opštine
Br. 001/011-82539
Dana 31 maj 2018
P r i z r e n

Predsedavajući Skupštine
Artan Abrashi

07-06-2018
-01- 020-670

Neni 5

Ky Vendim, hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të prodhojë efekt juridik pas vlerësimeve sikurse në nenin 81 dhe 82 të LVL-së.

KOMUNA E PRIZRENIT
Kuvendi i Komunës
Nr. 001/011-82539
Me 31 maj 2018
P r i z r e n

Kryesuesi i Kuvendit
Artan Abrashi

# Komuna e Prizrenit dhe Bashkia Berat
# Marrëveshje e Vullnetit të Mirë

E nënshkruar më 28.04.2018 në Komunën e Prizrenit

**Ndërmjet :**

Z. Mytaher Haskuka

Kryetari i Komunës së Prizrenit

**dhe :**

Z. Petrit Sinaj

Kryetari i Bashkisë Berat

Përfaqësuesi i Qytetetit të Prizrenit Republika e Kosovës dhe përfaqësuesi i Bashkisë së Berat Republika e Shqipërisë, të zgjedhur ligjërisht prej qytetarëve të tyre, të sigurtë për të qenë përgjegjës për nevoja reale të komuniteteve të tyre dhe për detyrimet ndaj komuniteteve të tyre;

Të bindur që kontaktet ndërmjet komuniteteve të qyteteve respektive do të kontribuojnë për pasurimin e kulturave të qytetarisë së tyre dhe do të forcojnë lidhjet e miqësisë ndërmjet Prizrenit dhe Beratit;

Nënshkruajnë këtë Marrëveshje të Vullnetit të Mirë, me qëllimin e qartë për të zgjeruar shkëmbimet dhe eksperiencat në sektorët e kulturës, ekonomisë, turizmit, trashëgimisë, me qëllimin për të dhënë një kontribut për forcimin e marrdhënieve ndërmjet qyteteve respektive.

Ne konfirmojmë vullnetin tonë nëpërmjet nënshkrimit të kësaj marrëveshje.

| | |
|---|---|
| **z.Mytaher Haskuka** | **z.Petrit Sinaj** |
| **Kryetari i Komunës së Prizrenit** | **Kryetari i Bashkisë Berat** |